



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Datë: 28.09.2026

Prishtinë

Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall:

KONKURS

Për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme të larta për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për vitin shkollor 2026/2027

1. Kushtet e përgjithshme për ndarjen e bursave:

Bursat ndahen për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të regjistruar në klasën e 10-të, 11-të, 12-të, të arsimit të mesëm të lartë, gjimnaze dhe shkolla profesionale në Republikën e Kosovës, për vitin shkollor 2026/2027.

2. Qëllimi i projektit të bursave:

Qëllimi i projektit për ndarjen e bursave është ofrimi i mbështetjes financiare për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ministria e Arsimit dhe Shkencës mbështet politika dhe programe të cilat sigurojnë arsimim kualitativ edhe për nxënësit e komuniteteve.

Objektivat kryesore të projektit janë:

- a. Përfshirja e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë në shkollat publike të Republikës së Kosovës;
- b. Sigurimi i iniciativave, përfshirë ndarjen e bursave për të reduktuar braktisjen e mësimit tek nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- c. Rritja e numrit të nxënësve të cilët do të ndjekin arsimin e mesëm të lartë, përmes mbështetjes financiare me bursa;
- d. Ngritja e suksesit të nxënësve duke iu ofruar mbështetje financiare.

3. Dokumentet e nevojshme për aplikim në platformën online eKosova:

- a. Vërtetimi nga shkolla se nxënësi është në njërën nga klasat e shkollës së mesme të lartë në shkollat publike të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 2026/2027;
- b. Dëftesa për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) - arsimit të obligueshëm, ose dëftesa mbi përfundimin e vitit paraprak të shkollës së mesme të lartë (10 dhe 11);
- c. Për raste sociale – Vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale i cili vërteton se familja merr ndihmë sociale dhe Vërtetimi nga Qendra për Punësim për statusin e punësimit për të dy prindërit (apo kujdestarin) që të dy prindërit janë të papunë;
- d. Në rast se prindi është në marrëdhënie pune të ngarkohet vërtetimi nga punëdhësi që është në marrëdhënie pune;
- e. Për fëmijët jetimë – të dorëzohet vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale;
- f. Vetëdeklarimi për përkatësinë etnike nga aplikuesi
- g. Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës (personale dhe / e prindit apo e kujdestarit ligjorë);
- h. Kopjen e llogarisë personale apo të prindit.
- i. Të gjitha dokumentete e ngarkuara në platformën online në eKosova duhet të duken qartë.

Vërejtje:

Llogarija bankare duhet të jete rrjedhëse dhe aktive nuk pranohen llogari të kursimeve apo e pensionistëve.

4. Kriteret për ndarjen e bursave:

Përzgjedhja e fituesve të bursave do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në vijim:

- a) Sukses i bazuar në notë mesatare nga shkolla/klasa paraprake;
- b) Vërtetimi për gjendjen socio – ekonomike të nxënësit (punësimin e prindit, statusin familjar dhe jetesën) – vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale;
- c) Vendbanimi;
- d) Gjinia e nxënësit (kandidatët femra kanë përparësi në përzgjedhje);
- e) Mungesa e përkujdesit prindëror (sipas dëshmisë).

Kandidatët rangohen sipas numrit të tërësishëm të pikëve të fituara nga kriteret e përcaktuara me këtë konkurs.

5. Afati i aplikimit dhe përzgjedhja e përfituesve:

Afati për aplikim fillon më **28.09.2026** dhe mbaron më **12.10.2026**

Rezultatet do të shpallen më së largu deri më **4 nëntor 2026** në ueb faqen e MASH

<http://masht.rks-gov.net/publikimet>.

6. Lartësia dhe numri i bursave:

Lartësia e bursave është 40 euro në muaj, apo 400 euro për një vit mësimor.

Numri i nxënësve që mund të përfitojnë bursë për vitin shkollor 2026/2027 është 500 nxënës.

Pagesa e bursave bëhet gjatë vitit mësimor, përmes xhirollogarisë, në bazë të kësteve të përcaktuara nga Komisioni i MASH, në 1 apo më shumë këste.

7. Mënyra e aplikimit:

Aplikacioni do të jetë i hapur në platformën online eKosova nga data 28.09.2026 deri më 12.10.2026 në ora: 24:00. Fillimisht kandidati që aplikon për bursë duhet të regjistrohet në platformën online në eKosova.

Vegëza për aplikim:

<https://ekosova.rks-gov.net/678>

Për ndihmë rreth regjistrimit dhe aktivizimit të llogarisë në eKosova na kontaktoni përmes: Tel: 038 200 30 900; 0800 30 900 apo e-mail: ekosova@rks-gov.net

Për sqarime shtesë rreth kriterëve të konkursit vizitoni faqen <https://mash.rks-gov.net> apo në e-mail: nazan.safqi@rks-gov.net & samir.keric@rks-gov.net

Kandidatët e pakënaqur mund të ushtrojnë ankesë brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes së rezultateve në web faqen e MASH.

Ankesa mund t'i paraqitet komisionit për ankesa dhe parashtresa në MASH. Ankesa duhet të jetë e arsyetuar dhe të ketë të bashkëlidhura dokumentet që e argumentojnë ankesën. Përgjigjja në ankesë do të jepet brenda 30 ditësh nga dita e pranimit.

Sipas vendimit të Komisionit përzgjedhës për ndarjen e bursave, MASH nxjerr vendim për përfituesit e bursave. Bursa jepet pa obligim për kthim. MASH, do ta bëjë monitorimin e vijueshmërisë së nxënësve përfitues. Shfrytëzuesit të bursës do t'i ndërpritet bursa në rast se është përfitues i ndonjë burse tjetër, nëse braktis shkollimin, apo ka numër të paarsyeshëm të mungesave në vijueshmëri të mësimit dhe nëse ka rënie të madhe të suksesit.